**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE**

## Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

| Data: 22.07.2024 | Nr: 106 | Ora: 18:30 |
|---|---|---|

# VENDIM

## PËR SHQYRTIMIN E KËRKESËS SË KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT, PËR AKREDITIMIN E VËZHGUESVE PËR VËZHGIMIN E ZGJEDHJEVE TË PJESSHME PËR KRYETAR TË BASHKISË HIMARË TË DATËS 4 GUSHT 2024

Sot në datën 22.07.2024, unë, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, pasi shqyrtova kërkesën e:

**KËRKUES:** Komiteti Shqiptar i Helsinkit, me adresë në Rr. "Brigada e VIII", Kulla "Tekno Projekt" , Hyrja 2, Apartmenti 10, Kati 6;

**OBJEKTI:** Kërkohet akreditimi si vëzhgues për vëzhgimin e zgjedhjeve te pjesshme për Kryetar të Bashkisë Himarë të datës 4 gusht 2024.

**BAZA LIGJORE:** Nenet 6, 7 e 19, pikat 1, shkronja "n", e 2, të ligjit nr.10019, datë 29.12.2008, "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë". Vendimi nr. 19, datë 27.01.2023, i Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, "Për procedurat e akreditimit dhe rregullat e vëzhgimit të zgjedhjeve nga organizatat joqeveritare shqiptare dhe të huaja, organizatat ndërkombëtare, përfaqësues të shteteve të huaja, dhe mediave".

## V Ë R E J:

Komiteti Shqiptar i Helsinkit i ka paraqitur Komisionit Qendror të Zgjedhjeve kërkesën, si dhe dokumentacionin përkatës për akreditimin e 5 vëzhguesve si dhe zonat e vëzhgimit të tyre.

Kërkesa është paraqitur në datën 17.07.2024.

Komiteti Shqiptar i Helsinkit, në respektim të nenit 6, pika 2 të Kodit Zgjedhor është një organizatë që gëzon të drejtën të caktojë vëzhgues në zgjedhje.

Kërkesa e paraqitur respekton afatin kohor të përcaktuar në nenin 6, pika 5, të Kodit Zgjedhor.

Dokumentacioni shoqërues i kërkesës është në përputhje me përcaktimet e nenit 6, pika 4 e vijues të Kodit Zgjedhor

## PËR KËTO ARSYE:

Si dhe në mbështetje të neneve 6, 7 e 19, pikat 1, shkronja "n", e 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, si dhe vendimit nr. 19, datë 27.01.2023, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, "Për procedurat e akreditimit dhe rregullat e vëzhgimit të zgjedhjeve nga organizatat joqeveritare shqiptare dhe të huaja, organizatat ndërkombëtare, përfaqësues të shteteve të huaja, dhe mediave",

## V E N D O S :

1. Akreditimin e 5 vëzhguesve të Komiteti Shqiptar i Helsinkit për vëzhgimin e zgjedhjeve të pjesshme për Kryetar të Bashkisë Himarë të datës 4 gusht 2024, sipas listës së përcaktuar në lidhjen 1 që i bashkëlidhet këtij vendimi.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim brenda 1 (një) dite nga shpallja e tij në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve.

**Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve**

**Ilirjan CELIBASHI**

Aneksi 1: Lista e Vëzhguesve te Miratuar te Komiteti Shqiptar i Helsinkit

| | Emri | Mbiemri | Mandati | Seriali | Zona e vezhgimit |
|---|---|---|---|---|---|
| **1.** | Teuta | Pataj | Afatgjate | 000034 | Vlorë |
| **2.** | Emanuel | Xhindi | Afatgjate | 000035 | Vlorë |
| **3.** | Klajdi | Mone | Afatgjate | 000036 | Vlorë |
| **4.** | Erida | Skëndaj | Afatgjate | 000037 | Vlorë |
| **5.** | Nosiana | Burnazi | Afatgjate | 000038 | Vlorë |